

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Vendi ka pësuar dëme të pallogaritshme", ish-ministri Sandër Lleshaj thirrje politikës të marrë masa: Gjë më e padëgjuar kurrë, qytetarët nuk kanë kujt t'i besojnë më
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/vendi-ka-pesuar-deme-te-pallogaritshme-ish-ministri-sander-lleshaj-thir-i402012
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 06:36:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 06:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b283c2b82c3a5717a88bc94539316b74b2c5d207800dbb939a740bedd886ceab
TEKSTI	6d43c94f962b5f592890230fd1b97cb251d4062db24b8325df930c06cd45ed8b
PAMJA	b3bf3af9ce0e93501b1b94ea94c5c247575e664730e209370b816676d11a0066

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3b365f64640093ad4903d0a1302baa2eccfef85b0691bf6af42f0094a30f8362
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	491fbc2f0e2919ed311b022f1b5f92632a55c8ad6fb3d3a6ed9398e35c5643c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/3b365f64640093ad4903d0a1302baa2eccfef85b0691bf6af42f0094a30f8362

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Politikë

25 Shtator 2026, 08:36

"Vendi ka pësuar dëme të pallogaritshme", ish-ministri Sandër Lleshaj thirrje politikës të marrë masa: Gjëmë e padëgjuar kurrë, qytetarët nuk kanë kujt t'i besojnë më

Shkruar nga Newsbomb



Ish-ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

Ish-ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj i bën thirrje klasës politike që të reagojë menjëherë dhe të marrë masa, për atë që ai e quan gjëmë me Shërbimin Informativ të Shtetit. Drejtuesja Vlora Hyseni është shkarkuar dhe ndodhet në masë arresti për nxjerrje të sekreteve.

Ai thotë se diskutimi publik për ish-drejtuesen e shërbimit tashmë nuk ka asnjë vlerë, përpos devijimit të diskutimit në detaje banale romantike, por tërmeti katastrofik i ndodhur duhet të shërbejë për të diskutuar rreth shërbimit dhe jo rreth drejtueses së pafat të tij.

"Vënia nën masë arresti e Drejtores së Shërbimit Informativ të Shtetit duket se i ka alarmuar të gjithë. Arrestimi është lajm i padëgjuar kurrë ndër ne e më përtej, ndërkohë që devijimet alarmate të këtij shërbimi nga ligji nuk kanë munguar përgjatë historisë tonë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Në kulmin e krizës së karburanteve, qeveria pritet të shtojë një taksë të re për naftën, efekti 40 milione euro/vit



Aktualitet

Moti bën kthesën e papritur, Shërbimi Ushtarak: Sot priten reshje shiu me shtrëngata, breshër dhe dëborë

Zbulu më shumë artikuj >

Është i mirëkuptueshëm dhe i ligjshëm zemërimi i qytetarëve të zakonshëm, që tashmë nuk dinë se kujt t'i besojnë më në këtë vend.

Por e papranueshme është maskarada e politikanëve dhe e deputetëve që nxitojnë të lajnë duart apo të përбетohen për ndershmëri, moral apo integritet, ndërkohë që kanë fjetur gjumë (në rastin më të mirë) për gati tri dekada rrënuese për vetë shërbimin informativ”, shkruan Sandër Lleshaj.

Ushtaraku dhe ish-ministri i Brendshëm i Shqipërisë, thekson se ndërprerja e menjëhershme e dëmeve të pallogaritshme që shërbimi dhe vendi kanë pësuar nga kjo gjërmë, që ende po ndodh, si dhe marrja e masave për ndërtimin e një shërbimi të mirëfilltë inteligjent të bazuar në parime, përvoja dhe standarde demokratike dhe perëndimore, është sot një detyrë emergjente kombëtare.

“Drejtesit politikë përgjegjës dhe deputetët, që aktrojnë sot plot hipokrizi për dramën, duhet të pyesin vetën dhe t'i përgjigjen popullit shqiptar për disa pyetje të rëndësishme:

1. A e dini se ligji në fuqi për Shërbimin Informativ të Shtetit është i bazuar në Dispozitat Kushtetuese të vitit 1991, pra jo në ndonjë kushtetutë, por dispozitat provizore që tepruan si rrënojë nga Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976?!

2. A e dini se cili parlament i ka miratuar këto dispozita?!

3. A ju vjen turp për këtë?!

4. Përse përmes mosveprimit tuaj keni lejuar që ky shërbim informativ, që në fakt duhej të ishte një shërbim inteligjent, të funksionojë në bazë të një ligji qesharak që është më i vjetër se sa vetë Kushtetuta e Shqipërisë?

5. Përse nuk kuptoni ende se, në këto rrethana, për gati tri dekada, praktikisht Shërbimi Informativ funksionon pa ligj?

6. Përse nuk kuptoni ende se një shërbim që funksionon “de facto” pa ligj është një kërcënim potencial serioz për liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe për rrjedhojë edhe për sigurinë e vendit.

7. Përse keni lejuar që Shërbimi Informativ të jetë struktura më e pakontrolluar në Shqipëri, ndërkohë që strukturat homologe nga vendet e NATO-s dhe vendet e tjera demokratike janë më të kontrolluarat ndër të gjitha institucionet e një shteti normal?”, shkruan Sandër Lleshaj.



Lexo gjithashtu



E Enjte 23:19

Fenomeni i gjyqtarëve "infekton" dhe kryebashkiakët, demokrati i Mirditës kërkon rrogë 2.5 milionë në fund të shtatorit dhe do që rritja të nisë nga 1 Janari 2026 (SHKRESA)



Politikë

Sali Berisha ndjek emisionin dhe zbulon kush e solli Viora Hysenin në Shqipëri për të drejtuar Shërbimin Informativ

E Enjte 22:13



Politikë

Ambasadorja e Izraelit mbyll misionin në Shqipëri, kryeministri Edi Rama e nderon me Yllin e Mirënjohjes Publike (NGJARJA TE VILA E KUQE)

E Enjte 20:16



E Enjte 18:44

"Si nuk i fiku njeri radarët për mua", Kryemadhi batuta në derën e SPAK: Tani nuk i hyj më në punë njeriu se jam me 3

kalamaj, Ilir Meta i ndizte dhe puthte...



Politikë

Hetimet dhe masa e sigurisë ndaj Viora Hysenit, ambasadori i Italisë flet nga Korça: Ne trajtojmë çështjet e bashkëpunimit...

E Enjte 16:49



Politikë

"E gjithë Kryeministria e dinte për lidhjen e Agasit dhe Viora Hysenit", Berisha plas "bombat": Ajo do kërcënojë prokurorët, tre gazetarë shqiptarë duhet të futen në burg

E Enjte 13:50



E Enjte 12:52

"Të ka filmuar Ergys Agasi dhe je në shantazh", Blushi akuzon Peleshin, kryeparlamentari i kthehet me "të njëjtën monedhë": Ti mbase po



Politikë

Viora Hyseni "fikte radarët" për Ergys Agasin, Berisha ngre dyshime edhe për ministren socialiste, e pyet në Kuvend: Keni kaluar ju zonjë nga zyra e tij?

E Enjte 11:50



Politikë

Tensione në Kuvend, Flamur Noka merr "peng" foltoren, Peleshi përplaslet me Topallin: Ç'a ke, ç'a ke...hajde këtu hajde..

E Enjte 11:29





🕒 E Enjte 10:43

Berisha insinupon se ka dosjen Hyseni/Agasi: Damian, shih se gjen veten aty! Ulsi, të del emri në shumë faqe (DEKLARATAT)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.